

VENDIM
Nr. 31/2014

PËR NDËRPRERJEN E MANDATIT TË ZOTIT ALFRED PRIFTI SI ANËTAR I KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, neni 12 i tij, si dhe në zbatim të neneve 19, pika 1, dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ndërpritet mandati i zotit Alfred Prifti, si anëtar i Komisionit të Shërbimit Civil, i zgjedhur me vendimin e Kuvendit nr. 105, datë 16.6.2011, në zbatim të nenit 5 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 22.5.2014

VENDIM
Nr. 32/2014

PËR NDËRPRERJEN E MANDATIT TË ZOTIT FATMIR TAFAJ SI ANËTAR I KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, neni 12 i tij, si dhe në zbatim të neneve 19, pika 1, dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ndërpritet mandati i zotit Fatmir Tafaj, si anëtar i Komisionit të Shërbimit Civil, i zgjedhur me vendimin e Kuvendit nr. 71, datë 4.11.2010, në zbatim të nenit 5 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 22.5.2014